

## **UDHËZIM NR. 1 DATË 18.12.2019**

### **PËR ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE NË URDHURIN E MJEKËVE TË VITIT 2020**

Në zbatim të Ligjit Nr 123/2014 “Për Urdhrit e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, Statuti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i miratur me vendimin e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë me Nr. 1, datë 19.06.2015, I ndryshuar, me qëllim të korigjimit të problematikave e ndryshme të hasura gjatë zgjedhjeve të zhvilluara për në Urdhrit e Mjekëve të Shqipërisë gjatë viteve të kaluara, si dhe për efekt transparence dhe informacioni për anëtarësinë e këtij organizimi, paraqes këtë akt udhëzimi për Këshillat Rajonale të Urdhrit të Mjekëve dhe strukturat përkatëse të Aparatit Qëndror Ekzekutiv pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë si më poshtë:

#### **Neni 1.**

##### **Ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Kandidaturave (KVK).**

Për organizimin sa më korrekt dhe të paanshëm të zgjedhjeve, si dhe për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara qartë si në Ligjin Nr. 123/2014 “Për Urdhrit e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, ashtu edhe në statutin e tij, nevojitet ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Kandidaturave.

Ky komision përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, që ngrihet me Urdhër të Presidentit të Këshillit Kombëtar.

Ky komision në zbatim të ligjit, statutit dhe të këtij udhëzimi do të bëjë vlerësimin e kandidaturave të paraqitura, për anëtarë të këshillave rajonale, Presidentë të këshillave rajonale, anëtarë të Këshillit Kombëtar dhe të Presidentit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

Lista e kandidatëve të paraqitur konform këtij udhëzimi, do të shpallet nga data 20.12.2019 deri më date 20.01.2020.

Njoftimi për paraqitjen e kandidaturave do të bëhet publike në faqen zyrtare të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

Pas datës 20.01.2020, të gjitha aplikimet e paraqitura pranë Këshillave Rajonale përkatëse, do të shqyrtohen nga ky komision.

#### **Neni 2**

##### **Ngritja e Komisionit të Administrimit të Zgjedhjeve (KAZ).**

Për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve nevojitet ngritja e Komisionit të Administrimit të Zgjedhjeve, që do të përbëhet nga 3 anëtarë që ngrihet me Urdhër të Presidentit të Këshillit Kombëtar.

Ky komision do të merret me organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë së vitit 2020, anëtarët e këshillave rajonale, Presidentët e Këshillave Rajonale, të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë si dhe të Presidentit të K.K.U.M.SH-së.

Anëtari i këtij Komisioni do të jetë Sekretari Rajonal përkatës në detyrë dhe për zgjedhjet në Këshillin Kombëtar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm.

Komisioni Administrimit të Zgjedhjeve ka për detyrë:

- regjistrimin e kandidaturave të konfirmuara nga KVK, dhe përgatitjen e materialeve zgjedhore me kandidaturat;
- nxjerrjen e listës së mjekëve votues sipas rajoneve;
- hartimin dhe prodhimin e regjistrave dhe materialeve zgjedhore;
- administrimin e zgjedhjeve pranë këshillave rajonale si për asamblatë rajonale ashtu dhe për zgjedhjet e anëtarëve të këshillave rajonale dhe të presidentëve të tyre.
- mbajtjen e procesverbalit gjatë zgjedhjeve;
- numërimin e fletëve të votimit;
- shpalljen e rezultatit përfundimtar të votimit.

### **Neni 3**

#### **Paraqitja e kandidaturave për në këshillat rajonale.**

Çdo mjek, anëtar i rajonit mund të paraqesë kandidaturën, brenda afateve të përcaktuara për në anëtarësinë e këshillit e rajonal përkatës, duke e paraqitur kërkesën me shkrim dhe duke e protokolluar atë pranë Këshillit Rajonal të Urdhrit të Mjekëve përkatës.

Njoftimi për paraqitjen e kandidaturave bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

Kriteret për kandidatë, anëtarë të këshillave rajonale janë:

- a.** të jetë shtetas shqiptar;
- b.** të jenë anëtarë të regjistruar pranë Urdhrit për një periudhë kohore 10 vjeçare, pandërprerje;
- c.** të ketë reputacion etiko-moral dhe profesional;
- ç.** të ketë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikuese, dhe të ketë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave dhe rregullave në jetën shoqërore, në komunikimin me publikun, pacientët, kolegët, si dhe me drejtuesit;

**d.** të mos jetë ndëshkuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundravajtje penale, si dhe gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të mos ketë marrë masa ndëshkimore disiplinore.

**dh.** të mos ketë funksione drejtuese në administratën shtetërore dhe të mos bëjë pjesë në forume drejtuese partiake të çdo niveli qofshin, nga të cilat detyrimisht duhet të jetë dorëhequr në momentin e kandidimit.

**e.** të ketë kontribute dhe të ketë qenë i aktivizuar në strukturat dhe veprimtaritë e Urdhrit;

Në zbatim të ndryshimeve të fundit të statutit të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë përfaqësimi i anëtarëve për në këshillat rajonale është:

| <b>Këshilli Rajonal i Urdhrit të Mjekëve</b> | <b>Totali Anëtarëve</b> | <b>Nr.</b> | <b>Qyteti</b> | <b>Nr.</b> | <b>Qyteti</b>    | <b>Nr.</b> | <b>Qyteti</b> | <b>Nr.</b> | <b>Qyteti</b> |
|--|-------------------------|------------|---------------|------------|------------------|------------|---------------|------------|---------------|
| <b>Berat</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 2(dy)      | Berati        | 1(një)     | Kuçova           | 1(një)     | Ura Vajgurore | 1(një)     | Skrapari      |
| <b>Dibër</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 3(tre)     | Dibra         | 1(një)     | Burreli          | 1(një)     | Bulqiza       |            |               |
| <b>Durrës</b>                                | <b>5(pesë)</b>          | 4(katër)   | Durrësi       | 1(një)     | Kruja            |            |               |            |               |
| <b>Elbasan</b>                               | <b>5(pesë)</b>          | 2(dy)      | Elbasani      | 1(një)     | Peqin            | 1(një)     | Librazhdi     | 1(një)     | Gramsh        |
| <b>Fieri</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 3(tre)     | Fieri         | 1(një)     | Ballshi          | 1(një)     | Lushnja       |            |               |
| <b>Gjirokastrë</b>                           | <b>5(pesë)</b>          | 3(tre)     | Gjirokastra   | 1(një)     | Përmeti Tepelena | 1(një)     | Saranda       |            |               |
| <b>Korçë</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 2(dy)      | Korça         | 1(një)     | Erseka           | 1(një)     | Pogradeci     | 1(një)     | Bilishti      |
| <b>Kukës</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 3(tre)     | Kukësi        | 1(një)     | Tropoja          | 1(një)     | Hasi          |            |               |
| <b>Lezhë</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 3(tre)     | Lezha         | 1(një)     | Kurbini          | 1(një)     | Rrëshen       |            |               |
| <b>Shkodër</b>                               | <b>5(pesë)</b>          | 3(tre)     | Shkodra       | 1(një)     | Puka             | 1(një)     | Malësia Madhe |            |               |
| <b>Tiranë</b>                                | <b>7(shtatë)</b>        | 6(gjashtë) | Tirana        | 1(një)     | Kavaja           |            |               |            |               |
| <b>Vlorë</b>                                 | <b>5(pesë)</b>          | 5(pesë)    | Vlora         |            |                  |            |               |            |               |

Anëtarët aktualë të këshillave rajonale regjistrohen si kandidatë për rizgjedhjen si anëtarë të Këshillave e Rajoneve përkatëse, përveç rasteve kur kërkojnë me shkrim mos marrjen pjesë si kandidatë.

Kandidati, brenda afatit të përcaktuar në nenin 1 të këtij udhëzimi, duhet të paraqesë së bashku me kërkesën për aplikim për kandidaturë këto dokumente:

- Kërkesën ku shprehet qartë lidhur me kandidimin për anëtar të Këshillit Rajonal,
- Kërkesën ku shprehet qartë lidhur me kandidimin për President të Këshillit Rajonal,
- Dokument identifikimi të vlefshëm;
- Kopje të lejes së ushtrimit individual të profesionit të vlefshme;
- Kartën e anëtarësisë;
- Vërtetim nga institucioni ku punon lidhur me pozicionin dhe me ekzistencën e masave administrative të marra ndaj tij.
- Curriculum Vitae.

Pavarësisht nëse kandidati ka paraqitur kërkesë dhe është vlerësuar e vlefshme kandidatura e tij nga KVK, për të kandiduar për pozicionin e Presidentit të Këshillit Rajonal përkatës, ai nuk mund të kandidojë nëse ai paraprakisht nuk zgjidhen si anëtar i këtij këshilli rajonal.

#### **Neni 4**

##### **Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.**

Asambleja Kombëtare përbëhet nga tërësia e të gjithë anëtarëve të Këshillave Rajonale dhe është organi më i lartë drejtues dhe vendimmarrës.

Presidenti dhe Zv. Presidenti i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, ekzistues, janë anëtarë të Asamblesë Kombëtare.

vc

#### **Neni 5**

##### **Paraqitja e kandidaturave për anëtarë të këshillit kombëtar dhe të presidentit.**

Në zbatim të pikës 2 nenit 17 – Këshilli Kombëtar, në statutin e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë sqarohet se presidentët e Këshillave Rajonale të sapo zgjedhur, me qëllim përfaqësimi të të gjitha rajoneve në këtë këshill, votohen në grup nga asambleja kombëtare.

Në zbatim të nenit 13, ligji Nr. 123/2014 “Për urdhrin e mjekëve të Shqipërisë” Presidenti dhe Zv. Presidenti i Këshillit Kombëtar, në rast rikandidimi për në këshillin kombëtar janë anëtarë.

Pas përfundimit të procedurave të mësipërme asamblea kombëtare procedon me zgjedhjen e kandidatëve të ngelur për anëtarë të Këshillit Kombëtar, të cilët zgjidhen me shumicën e thjeshtë të votave.

Konformë statutit, asamblea kombëtare votimin e kandidatëve e bën të hapur, me përjashtim të rasteve, kur vetë asamblea vendos ndryshe.

Kriteret për kandidatë, anëtarë të këshillit kombëtar janë:

**a.** të jetë shtetas shqiptar;

**b.** të jenë anëtarë të regjistruar pranë Urdhrit për një periudhë kohore 10 vjeçare, pandërprerje;

**c.** të ketë reputacion etiko-moral dhe profesional;

**ç.** të ketë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikuese, dhe të ketë shfaqur korrektësi në zbatimin e normave dhe rregullave në jetën shoqërore, në komunikimin me publikun, pacientët, kolegët, si dhe me drejtuesit;

**d.** të mos jetë ndëshkuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundrvajtje penale, si dhe gjatë 5 (pesë) viteve të fundit të mos ketë marrë masa ndëshkimore disiplinore.

**dh.** të mos ketë funksione drejtuese në administratën shtetërore dhe të mos bëjë pjesë në forume drejtuese partiake të çdo niveli qofshin, nga të cilat detyrimisht duhet të jetë dorëhequr në momentin e kandidimit.

**e.** të ketë kontribute dhe të ketë qenë i aktivizuar në strukturat dhe veprimtaritë e Urdhrit;

Kandidatët për president të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, janë kandidatë anëtarët e përzgjedhur të Këshillit Kombëtar, të zgjedhur nga asamblea.

Kriteret për kandidatë, President i këshillit kombëtar dhe Presidentë të Këshillave Rajonale janë kriteret e përcaktuara në pikën 4 dhe 5 të nenin 15, i ligjit Nr. 123/2014 “Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”:

- të jenë jo më shumë se në moshën e daljes në pension në momentin e zgjedhjes;
- të kenë jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesion;
- të kenë përvojë dhe të dhëna të besueshme për aftësi komunikimi, organizimi e drejtimi;
- të mos jenë marrë ndaj tyre masa ndëshkimore disiplinore në 5 vitet e fundit;
- të kenë prestigj dhe reputacion etiko-moral dhe profesional;
- të kenë kryer botime shkencore;
- të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- funksioni i presidentëve të Urdhrit të Mjekëve është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër administrativ, shtetëror apo politik

Personat që synojnë të kandidojnë për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë apo për President të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, të dorëzojnë kërkesën ku shprehen qartë lidhur me kandidimin e tyre për këto poste drejtuese.

Kërkesa për kandidim në Anëtarësinë e Këshillit kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, si dhe për postin e Presidentit të këtij këshilli, duhet të paraqitet, brenda afatit të përcaktuar në nenin 1 të këtij udhëzimi, nga data 20.12.2019 deri më datën 20.01.2020.

Pavarësisht nëse kandidati ka paraqitur kërkesë për të kandiduar për në anëtarësinë e Këshillit Kombëtar, si dhe të pozicionit të Presidentit të këtij këshilli, ai nuk mund të kandidojë në këto poste nëse paraprakisht nuk zgjidhen si anëtar i këshillit rajonal, dhe në vijim si anëtar i Këshillit Kombëtar.

Votimi për zgjedhjen e Presidentit bëhet në mbledhjen e parë të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe do të jetë votim i mbyllur.

Votimi për zgjedhjen e presidentit bëhet mbështetur në kandidaturat e ngelura nga përzgjedhja.

## **Neni 6**

### **Përcaktimi i afateve dhe datave.**

Me qëllim të respektimit të përfundimit të afateve lidhur me mandatet e anëtarëve të Këshillave Rajonale të Urdhrit të Mjekëve, Presidentëve të Këshillave Rajonale, Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe të Presidentit të këtij të fundit, përcaktohen datat e mëposhtme me qëllim, marrjen e masave për zhvillimin e zgjedhjeve të vitit 2020 të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

- Nga data 20.12.2019 deri datën 20.01.2020, afati i paraqitjes së kandidaturave për:

- a. Anëtarë të këshillave rajonale;
- b. President të këshillit rajonal;
- c. Anëtarë të këshillit kombëtar;
- d. President të Këshillit Kombëtar.

- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Berat,

- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Dibër,

- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Durrës,

- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Elbasan,

- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Fier,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Gjirokastrë,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Korçë,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Kukës,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Lezhë,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Shkodër,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Tiranë,
- Data \_\_\_\_\_ .2020, zhvillimi i zgjedhjeve në K.R.U.M. Vlorë,
- Gjatë muajit Prill 2020, do të zhvillohet asambleja kombëtare të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar.
- Gjatë muajit Prill 2020, do të zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe zgjedhja e Presidentit të tij.

## **ZHVILLIMI I ZGJEDHJEVE PRANË KËSHILLAVE RAJONALE**

### **Neni 7**

#### **Fletët e votimit për në Këshillat Rajonale.**

Aparati Qendror pranë Këshillit Kombëtar merr të gjitha masat paraprake lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve pranë Këshillave Rajonale duke përgatitur Fletët e votimit, listën e zgjedhësve dhe çdo material tjetër të nevojshëm për zgjedhjet për secilin rajon.

Fletët e Votimit të çdo rajoni, do i dorëzohen Komisionit të Administrimit të Zgjedhjeve, nëpërmjet një proces verbal dhe pas përfundimit të zgjedhjeve dorëzohen pranë Aparatit Qendror të Këshillit Kombëtar nëpërmjet procesverbalit, së bashku me materialet e tjera.

Fletët e votimit nuk duhet të kenë asnjë shënim në të dhe do të vulosen nga Komisioni i Administrimit vetëm kur i dorëzohet votuesit, pas regjistrimit të tij në regjistrë.

Fleta e votimit duhet të përmbajë emrat e kandidatëve të paraqitur për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit Rajonal, nga ku në mënyrë automatike futen emrat e anëtarëve të këshillit rajonal ekzistues.

Për pasojë fleta e votimit do të jetë format A4. Për disa rajone referuar edhe numrit të kandidaturave të paraqitura "Fleta e votimit" mund të ketë edhe më shumë fletë.

Vendosja e emrave të kandidatëve në fletën e votimit do të bëhet sipas shkronjave të alfabetit nga A-ja tek ZH-ja.

## **Neni 8**

### **Zhvillimi i zgjedhjeve për Këshillat Rajonale.**

Ditën e përcaktuar në këtë udhëzim, përjashtuar rastet e jashtëzakonshme, duhet të zhvillohen zgjedhjet në rajonin përkatës, lidhur me përfaqësuesit e këshillit rajonal përkatës, në përpjestim me numrin e anëtarëve, siç parashikohet në nenin 3 të këtij udhëzimi.

Këshilli Rajonal ekzistues duhet të marrë të gjitha masat për gjetjen e ambjenteve për zhvillimin e zgjedhjeve dhe në bashkëpunim me Aparatin Qendror të Këshillit Kombëtar të marrë masa për mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e zgjedhjeve në rajon.

Këshilli Rajonal në bashkëpunim me Komisionin e Administrimit të Zgjedhjeve paraprakisht datës së zgjedhjeve, të përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi, duhet të zhvillojë zgjedhjet për anëtarin që përfaqëson anëtarësinë e këshillave në qytetet me anëtarësi të vogël që janë varësi e tyre (sipas tabelës në nenin 3).

Zhvillimi i zgjedhjeve në qytetet me anëtarësi të vogël do të zhvillohen nga Këshillat Rajonale përkatëse me ndihmën e Aparatit Qendror pranë Këshillit Kombëtar, duke qënë vetëm Sekretari dhe Presidenti i Këshillit Rajonal ekzistues që do të zëvendësojë rolin e K.A.Z..

Ditën e caktuar, në ambjentin e përcaktuar për zhvillimin e zgjedhjeve në rajon duhet të paraqitet Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve, i cili i merr të gjitha masat, për fillimin e procesit të votimit nga ora 08.00 deri në orën 14.00. Përjashtim bën K.R.U.M. Tiranës, që lidhur me numrin e lartë të anëtarësisë do të ketë një orar nga ora 08.00 deri në orën 18.00.

Këshilli Rajonal si dhe Aparati Qendror pranë Këshillit Kombëtar do të marrë të gjitha masat për njoftimin e anëtarësisë për datën dhe orarin e zhvillimit të zgjedhjeve sipas rajoneve.

Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve duhet të ketë materialet zgjedhore që janë:

- Lista rajonale e votuesve;
- Fletët e votimit;
- Kutinë e votimit;
- Regjistri i regjistrimit të votuesve të paraqitur;
- Librin e Procesverbalit;
- Vulën për vulosjen e proces verbalit dhe të fletëve të votimit.



Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve në orën 08.00 hap votimin dhe mban procesverbal lidhur me hapjen e votimit.

Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve, me fillimin e procesit të votimit, njëri nga anëtarët e tij realizon verifikimin e emrit të votuesit në listën përkatëse rajonale, ndërsa anëtari tjetër realizon regjistrimin e votuesit në Regjistrin e regjistrimit të votuesve të paraqitur duke bërë identifikimin e anëtarit nëpërmjet kartës së anëtarësisë së tij.

Kryetari i Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve pasi vulos Fletën e votimin e pajis votuesin me të dhe e orienton drejt kutisë së votimit.

Për anëtarët rajonal që nuk rezultojnë në listën përkatëse rajonale, pas verifikimit të mundshëm mund të bëhet shtimi me shkrim dore të emrit të tyre në pjesën fundore të listës dhe në fund të shënohet ky fakt në procesverbal.

Në orën 14.30 mbyllet procesi i votimit, votuesit e pranishëm të paraqitur para orarit të mbylljes regjistrohen në regjistër dhe lejohet të votojnë. Për rajonin e Tiranës orari i mbylljes do të jetë ora 18.30.

Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve mbyll votimin duke e shënuar në procesverbalin përkatës orarin e përfundimit të votuesit të fundit.

Pasi mbyllet procesi i votimit, Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve nis procesin e numërimit të votave, për anëtarët e këshillave rajonale përkatëse duke bërë shënimet përkatëse në proces verbal, për çdo problematikë të hasur.

Në fund, Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve nxjerr rezultatit lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të këshillave rajonale përkatëse, që e shënon në procesverbalin për nxjerrjen e rezultatit ku shënohet numri i votuesve të paraqitur, numri i fleteve të votimit të vlefshme, numri i fletëve të votimit të pavlefshme dhe rezultati përfundimtar sipas numrit të votuesve.

Kopje e këtij proces verballi i dorëzohet Këshillit Rajonal përkatës, i cili merr masat për komunikimin e rezultatit dhe të njoftimit e anëtarëve të këshillave rajonale përkatëse lidhur me votimin për zgjedhjen e Presidentëve të Këshillave Rajonal përkatës.

Në rast kontestimesh, nga ndonjë kandidat, paraqitet kërkesë për verifikim pranë Aparatit Qendror të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i cili për efekt transparence, brenda një afati të mundshëm, bën të mundur verifikimin e fletëve të votimit të rajonit përkatës.

Në raste se nga verifikimi, i kryer pranë Aparatit Qendror të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, vërehen ndryshime që ndikojnë në listën e shpalljes së rezultateve atëherë, ky aparat nxjerr listën përfundimtare të korrigjuar.

## **Neni 9**

### **Mënyra e votimit pranë Këshillave Rajonale.**

Në fletën e votimit përkatëse, përkrah emrit të çdo kandidati do të jetë një kuti (□), ku votuesi duhet të shënojë në të me shenjën “x” ose “+”. Çdo shënim tjetër nuk do të merret parasysh.

Duke ju përmbajtur numrit të përcaktuar në nenin 15 pika “b” e Statutit të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, si dhe nga pika 3 e këtij udhëzimi, nga kandidaturat e paraqitura votuesi do të votojë vetëm për numrin e anëtarëve të asamblesë së përcaktuar.

Çdo votues që voton mbi numrin e lejuar të anëtarëve, e bën të pavlefshme fletën e votimit.

Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve ka për detyrë t'i komunikojë edhe një herë votuesve numrin e kandidatëve që mund të zgjedhë votuesi, në momentin e dorëzimit të fletës së votimit.

Votuesi pasi realizon shënimin me “x” ose “+” të kandidatëve që ai përzgjedh duhet të palosë fletën e votimit 2 herë dhe ta fusë në kutinë e votimit përkatëse.

Nuk lejohet asnjë shënim në fletën e votimit, për pasojë çdo fletë votimi që do të konstatohet me shënime do të konsiderohet e pavlefshme dhe nuk do të numërohet. Numri i fletëve të pavlefshme do të shënohen në procesverbalin përkatës për nxjerrjen e rezultatit.

## **Neni 10**

### **Mënyra e numërimit të votave dhe shpallja e rezultatit.**

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe shënimit në proces verbal të mbylljes së tij, kryetari i Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve, pasi largon personat e paautorizuar nga ambienti fillon hapjen e kutisë.

Fletët e votimit nxirren një e nga një dhe pasi verifikohet nga të gjithë anëtarët e Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve lidhur me vlefshmërinë e fletës së votimit, fillon numërimi i kandidaturave të zgjedhura.

Sekretari i rajonit përkatës, me cilësinë e anëtarit të Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve pasi verifikon fletën e votimit bën shënimin lidhur me numërimin në procesverbalin e nxjerrjes së rezultatit përfundimtar.

Çdo kandidat i përzgjedhur nga votuesi, në procesverbalin e numërimit, i vendoset një shënjë “x”.

Në fund të numërimit të fletëve të votimit, të 3 anëtarët e Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve bëjnë secili numërimin e shenjave “x”, duke nxjerrë rezultatin për çdo kandidaturë.

Përzgjidhen si kandidatë fitues, kandidatët që kanë numrim më të lartë të votave.

Në rast se në kandidatët fitues ka kandidatë me vota të barabarta, ku njëri prej tyre duhet nuk mund të jetë anëtar si pasojë e plotësimit të numrit, fituesi përzgjidhet nëpërmjet shortit.

Pas shënimit në proces verbalin e numërimit të numrit përfundimtar të votave për secilin kandidat dhe nxjerrjen e kandidaturave fituese, mbahet proces verbali i nxjerrjes së rrezultatit përfundimtar, i cili pasi lexohet nga anëtarët e Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve firmoset nga secili nga ato.

Në rast se ndonjë anëtar ka kundërshtim apo kontestim lidhur me ndonjë procedurë apo veprim të këtij komisioni, ai bën shënim në proces verbalin e nxjerrjes së rezultetit përfundimtar duke pasqyruar në të pretendimin e tij.

Në rast të mos nënshkrimit të anëtarit të Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve në proces verbalin e nxjerrjes së rezultetit përfundimtar, dy anëtarët e tjerë shënojnë në të *“refuzon nënshkrimin”*

Atëherë kur kandidatët janë për short, procedura e hedhjes së shortit është nëpërmjet hedhjes së një monedhe nga ana e kryetarit të Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve.

Për hedhjen e shortit thirren të jenë të pranishëm, nëse është e mundur kandidatët përkatës, në pamundësi presidenti ekzistues i Këshillit Rajonal përkatës, me cilësinë e dëshmitarit.

Numërim i fletëve të votimit për anëtarë të asamblesë rajonale bëhet vetëm në praninë e Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve.

Numërimi i fletëve të votimit për anëtarë të këshillave rajonale mund të jenë të pranishëm vetëm kandidatët pretendentë, të cilët në asnjë rast nuk duhet të ndërhyjnë gjatë procesit. Për çdo kontestim apo vërejtje lidhur me procesin e votimit apo numërimit, që ato mund të kenë duhet t'i drejtohen me shkrim Aparatit Qendror pranë Këshillit Kombëtar. Në rast të mos paraqitjes së kontestimit anëtarët e pranishëm duhet të nënshkruajnë marrjen dijeni të rezultetit dhe pranimin e tij.

Numërimi i fletëve të votimit për anëtarë të këshillave kombëtar mund të jenë të pranishëm vetëm kandidatët pretendentë, të cilët në asnjë rast nuk duhet të ndërhyjnë gjatë procesit. Për çdo kontestim apo vërejtje lidhur me procesin e votimit apo numërimit, që ato mund të kenë duhet t'i drejtohen me shkrim Aparatit Qendror pranë Këshillit Kombëtar. Në rast të mos paraqitjes së kontestimit anëtarët e pranishëm duhet të nënshkruajnë marrjen në dijeni të rezultetit dhe pranimin e tij.

Numërimi i fletëve të votimit për Presidentin e këshillit kombëtar të urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë mund të jenë të pranishëm vetëm kandidatët pretendentë, të cilët në asnjë rast nuk duhet të ndërhyjnë gjatë procesit. Për çdo kontestim apo vërejtje lidhur me procesin e votimit apo numërimit, që ato mund të kenë duhet t'i drejtohen me shkrim Aparatit Qendror pranë Këshillit Kombëtar. Në rast të mos paraqitjes së kontestimit anëtarët e pranishëm duhet të nënshkruajnë marrjen dijeni të rezultatit dhe pranimin e tij.

Pas përfundimit të votimit nga ana e anëtarëve të asamblesë rajonale lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit rajonal përkatës, Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve shënon në proces verbal mbylljen e votimit dhe fillon procesin e numërimit të fletëve të votimit.

Në këtë proces mund të jenë të pranishëm kandidatët për anëtarë të këshillit rajonal përkatës, por nuk kanë asnjë të drejtë të bëjnë asnjë ndërhyrje.

Kopje e këtij proces verbali i dorëzohet Këshillit Rajonal përkatës, i cili merr masat për komunikimin e rezultatit dhe të njoftimit e anëtarëve të asamblesë rajonale përkatëse lidhur me votimin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Rajonal përkatës.

## **Neni 11**

### **Zgjedhja e Presidentit të Këshillit Rajonal.**

Pas nxjerrjes së rezultatit, anëtarët e sapozgjedhur të këshillit rajonal, zhvillojnë mbledhjen e parë të këtij këshilli.

Mbledhja e parë të këshillit rajonal të sapozgjedhur nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar.

Në mbledhjen e parë të këshillit rajonal bëhet edhe përzgjedhja e presidentit të këshillit rajonal, që do të jetë njëri nga 5 (pesë) anëtarët e sapo zgjedhur, i cili do të përzgjidhet me shumicën e thjeshtë të votave. Presidenti i Këshillit Rajonal të Urdhrit të Mjekëve të Tiranës zgjidhet njëri nga 7 (shtatë) anëtarët e këshillit rajonal të sapo zgjedhur.

Mbledhja mbahet nga sekretari ekzistues, ku janë të pranishëm 2 anëtarët e Komisionit të Administrimit të Zgjedhjeve.

Vendimi për zgjedhjen e Presidentit nga Këshilli Rajonal përkatës i komunikohet menjëherë Këshillit Kombëtar.

## **Neni 12**

### **Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Kombëtar**

Pas përfundimit të zgjedhjeve të anëtarësisë së këshillave rajonale, si dhe zgjedhjes së Presidentëve të këshillave rajonale, Presidenti ekzistues i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, në datën e caktuar thërret asamblenë kombëtare. Aparati Qendror pranë Këshillit Kombëtar ngarkohet për marrjen e masave për komunikimin e njoftimeve si dhe të masave për zhvillimin e asamblesë kombëtare.

Anëtarët e Asamblesë kombëtare kanë detyrimin për të marrë të gjitha masat që të jenë të pranishëm në asamblenë kombëtare.

Në zbatim të nenit 13 të ligjit Nr. 123/2014 “Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe të nenit 17 “Statuti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë” zgjidhen 20 anëtarët e Këshillit Kombëtarë.

Votimi për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë bëhet i hapur, me përjashtim të rastit kur asamblea kombëtare vendos ndryshe.

Duke qënë se presidentët e këshillave rajonale janë përzgjedhur nga asambletë rajonale, si dhe duke pasur parasysh rolin e tyre dhe përfaqësimin e rajonëve përkatëse pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, 12 presidentët votohen në bllok si anëtarë të këshillit kombëtar.

Kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Këshillit Kombëtar konkurojnë për vendet e ngelura dhe zgjidhen me votim të hapur, me përjashtim të rasteve kur vetë Asamblea kërkon të votohet ndryshe.

Kandidaturat, votohen nga asamblea kombëtare, dhe fitojnë kandidaturat që kanë marrë numrin më të madh të votave.

Data për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Kombëtar të sapo zgjedhur caktohet nga Presidenti ekzistues i Këshillit kombëtar, në të cilën do të bëhet edhe zgjedhja e presidentit të ri.

Votimi për zgjedhjen e Presidentit të Këshillit Kombëtar bëhet votim i mbyllur.

Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve merr të gjitha masat për organizimin e zgjedhjes së Presidentit të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë.

## **Neni 13**

### **Ankimimet dhe kontestimet në Aparatin Qendror**

Çdo kandidat që ka ndonjë ankesë për zhvillimin e procesit të votimit apo kontestim lidhur me rezultatin, duhet ta paraqesë me shkrim brenda 5 ditëve nga zhvillimi i procesit apo nga nxjerrja e rezultatit.

Aparati Qendror pas marrjes së ankesës apo të kontestimit të paraqitur nga kandidati, menjëherë merr në shqyrtim rastin duke bërë verifikimin e proces verbaleve të mbajtura

nga Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve si dhe kur konstaton së ka pasur shkelje të tilla që mund të kenë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve mund të vendosë përsëritjen e zgjedhjeve për atë rajon.

Në rast të kontestimit të rezultatit të votimit, Aparati Qendror mund të marrë vendim që në prani të Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve dhe të kandidatit që ka paraqitur kontestimi të bëj rinumërimin e fletëve të votimit.

Në rast kur nga rinumërimi i fletëve të votimi konstatohen ndryshime që ndikojnë në rezultatin përfundimtar, Aparati Qendror Ekzekutiv merr vendim duke shpallur rezultatin përfundimtar të votimit duke ndryshuar rezultatin e nxjerrë nga Komisioni i Administrimit të Zgjedhjeve.

## **Neni 14**

### **Dispozita të përgjithshme**

Ky udhëzim u vihet në dijeni të gjithë Këshillave Rajonale që në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe me strukturat e saj të merren me mirë organizimin e zgjedhjeve.

Ky udhëzim të bëhet publik për informimin e anëtarësisë lidhur me procedurat e kandidatimit, votimit, numërimit, dhe nxjerrjes së rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve.

Dr. Fatmir BRAHIMAJ

President